



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

Përfaqësimi gjinor në trupat për menaxhimin e zgjedhjeve

Analizë e të dhënave të Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2021



Përfaqësimi gjinor në trupat për menaxhimin e zgjedhjeve

Analizë e të dhënave të Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2021

Shtator, 2024.

Përgatitur nga:

- Nexhmedin Hyseni, Drejtor i Departamentit të Koordinimit në Terren, dhe
- Premtim Rustemi, Zyrtar i Lartë i Bazës së të Dhënave.

Rishikimi dhe Editimi nga:

- Demokraci për zhvillim (D4D)

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës.

© [2024] - [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve].

www.kqz-ks.org
Rruga Migjeni, Nr. 21
10 000, Prishtinë
Republika e Kosovës



PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| Hyrje | 4 |
| Metodologjia | 5 |
| Analiza e përfaqësimit gjinor në trupat për menaxhimin e zgjedhjeve | 6 |
| Rekomandimet | 9 |
| Shtojcat | 10 |

Shtojca 1:

Të dhënat e përgjithshme të KKZ-ve dhe të dhënat e shprehura në përqindje për numrin e anëtareve gra dhe burra për çdo komunë në Zgjedhjet Parlamentare 14 shkurt 2021 _____ 10

Shtojca 2:

Të dhënat e përgjithshme të KKZ-ve për secilën komunë përkatëse dhe të dhënat e shprehura në krahasimin në përqindje në dy palë zgjedhjet për numrin e anëtareve gra dhe burra për çdo komunë në Zgjedhjet Parlamentare 14 shkurt 2021 dhe Zgjedhjet Lokale 17 tetor 2021 _____ 12

Shtojca 3:

Të dhënat e përgjithshme të KVV-ve për secilën komunë përkatëse të dhënat shprehura në krahasimin në përqindje në dy palë zgjedhjet për numrin e anëtareve gra dhe burra për çdo komunë në Zgjedhjet Parlamentare të datë 14.02.2021 dhe Zgjedhjet Lokale të datë 14.11.2021 _____ 15

Shtojca 4:

Të dhënat e përgjithshme të KKZ-ve dhe të dhënat shprehura në përqindje për numrin e anëtareve gra dhe burra për çdo komunë në Zgjedhjet Lokale 17 tetor 2021 _____ 18

Shtojca 5:

Të dhënat e përgjithshme të KVV-ve dhe të dhënat shprehura në përqindje për numrin e anëtareve gra dhe burra për çdo komunë në Zgjedhjet Parlamentare 14 shkurt 2021 _____ 20

Shtojca 6:

Të dhënat e përgjithshme të KVV-ve dhe të dhënat shprehura në përqindje për numrin e anëtareve gra dhe burra për çdo komunë në Zgjedhjet Lokale 17 tetor 2021 _____ 22

Shtojca 7:

Paraqitja grafike - Të dhënat e shprehura në përqindje të përfaqësimit gra dhe burra sipas renditjes së komunave _____ 24

HYRJJE

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, përcakton që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të përpiqet ta garantojë përfaqësimin e drejtë në Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) për të gjitha komunitetet, me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen gjinore¹.

Në Raportin Përfundimtar të Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 14 shkurt 2021,² është theksuar se nuk ka kuota gjinore për përbërjen e komisioneve zgjedhore. Ashtu si në praktikën e kaluar, KQZ nuk publikoi asnjë informatë mbi përbërjen e KKV-ve dhe Këshillave të Vendvotimeve (KVV), përfshirë statistikën gjinore. Vëzhguesit qytetarë raportuan se gratë përbënin rreth 30 për qind të anëtarëve të KVV-ve me një përqindje më të ulët si kryetare të KVV-ve.

Ndërsa, Raportin Përfundimtar të Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian për Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor - 14 nëntor 2021³, është theksuar se vetëm një nga 11 anëtarët e KQZ-së është grua, ndërsa numri i përgjithshëm i grave anëtare të KKZ-ve ishte 46 nga 243 (19 për qind) dhe kishte vetëm pesë kryetare [gra] të KKZ-ve. Në këto zgjedhje, për herë të parë KQZ-ja ftoi organizatat e shoqërisë civile që të propozojnë gra për 16 KKZ-të ku subjektet politike nuk e kishin respektuar Deklaratën e shtatorit 2015 (*të nënshkruar nga 17 Subjekte Politike*) dhe nuk kishin propozuar gra. Megjithatë, vetëm 18 për qind e vendvotimeve të vizituara nga vëzhguesit e BE-së gjatë të dy raundeve kishin nga një grua si kryetare e KVV-së. Gratë si anëtare të KVV-ve

u vërejtën vetëm në 31 për qind të vendvotimeve të vizituara gjatë raundit të parë dhe vetëm në 25 për qind të vendvotimeve të vëzhguara gjatë raundit të dytë. Mbi 20 për qind e KVV-ve të vëzhguara në të dy raundet nuk kishin asnjë grua në mesin e anëtarëve të tyre.

Si rrjedhojë e kësaj, neni 14, Ligji për Barazinë Gjinore "Partitë politike me aktet e tyre obligohen të zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave në organet dhe trupat e partive, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji. Dhe se rekomandimi i Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian, për Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor - 14 nëntor 2021 ishte si në vijim "Partitë politike të marrin parasysh miratimin e politikave të brendshme për të promovuar pjesëmarrjen e grave dhe për të integruar çështjet gjinore në platformat partiake"⁴.

Ky raport përfshinë të dhënat e nxjerra nga listat e nominimeve të subjekteve politike për anëtarë të KKZ-ve dhe për anëtarë të KVV-ve të cilët i ka emëruar KQZ-ja në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 14 shkurt 2021 dhe në Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor - 14 nëntor 2021.

Raporti vë në pah numrin e përgjithshëm të KKZ-ve dhe KVV-ve sipas komunave përkatëse për personat e nominuar nga subjektet politike dhe të emëruar nga KQZ-ja, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përfaqësimit gjinor dhe individëve që kanë asistuar më shumë se një herë, qoftë brenda të njëjtit vendvotim apo në vendvotime të ndryshme brenda të njëjtës komunë.

¹ Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 67 paragrafi 3

² Bashkimi Evropian, Misioni Përcjellës i Zgjedhjeve "Raporti Përfundimtar". I qasshëm në: https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/document/s/EU%20EFM%20XKX%202022%20FR_al.pdf

³ Bashkimi Evropian Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve, Kosovë 2021, Raporti përfundimtar. I qasshëm në: https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/final_report_2021_eom_kosovo_municipal_elections_-_albanian.pdf

⁴ Po aty, faqe 34.

METODOLOGJIA

Për hartimin e këtij raporti, Departamenti i Koordinimit në Terren në bashkëpunim me Departamentin e Teknologjisë Informative të Sekretariatit të KQZ-së, duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2022, kanë ndjekur një metodologji që përfshinë nxjerrjen dhe analizimin e të dhënave lidhur me i) numrin e përgjithshëm për Kryesues dhe Anëtar të KKZ-ve për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 14 shkurt 2021; ii) numrin e përgjithshëm për Kryesues, Anëtar dhe Anëtarë Rezervë të KVV-ve për Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor dhe 14 nëntor 2021; iii) të dhënat krahasimore të numrit të përgjithshëm për Kryesues, Anëtar të KKZ-ve për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 14 shkurt 2021; iv) të dhënat krahasimore të numrit të përgjithshëm për Kryesues, Anëtar dhe Anëtar Rezervë të KVV-ve për Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor dhe 14 nëntor 2021.

Fillimisht, u mbledhën të dhënat për numrin e Kryesuesve të KKZ-ve bazuar në emërimet e bëra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Po ashtu, u përfshinë të dhënat për numrin e përgjithshëm të Anëtarëve të KKZ-ve, gjithashtu të emëruar nga KQZ, duke përfshirë ndarjen sipas komunave përkatëse. Këto të dhëna shërbyen për të pasqyruar shpërndarjen dhe përfaqësimin e anëtarëve në secilën komunë, duke ndihmuar në vlerësimin e barazisë dhe përfaqësimit të drejtë në këto komisione.

Pastaj është bërë mbledhja e të dhënave të detajuara për Kryesuesit, Anëtarët dhe Anëtarët Rezervë të Këshillave të Vendotimeve (KVV), që përfshinë të dhënat për numrin e Kryesuesve të KVV-ve të nominuar nga subjektet politike dhe të emëruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për secilin vendotim dhe qendër votimi në të gjitha komunat e Kosovës. Po ashtu, u mbledhën të dhënat për numrin e përgjithshëm të Anëtarëve të KVV-ve, të nominuar nga subjektet politike dhe të emëruar nga KQZ, për secilin vendotim. Janë përfshirë edhe të dhënat për numrin e Anëtarëve Rezervë të KVV-ve, që përfaqësonin 10% të përbërjes, të nominuar nga subjektet

politike dhe të emëruar nga KQZ në të gjitha komunat e Kosovës. Kjo metodë ndihmoi në pasqyrimin e përbërjes dhe funksionimit të plotë të këshillave zgjedhore në nivel lokal.

Si vazhdimësi e metodologjisë, raporti përfshiu edhe nxjerrjen dhe analizën e të dhënave krahasimore për Kryesuesit dhe Anëtarët e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe Këshillave të Vendotimeve (KVV) për dy procese të ndryshme zgjedhore.

Së pari, për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës më 14 shkurt 2021, u analizuan të dhënat për Kryesuesit dhe Anëtarët e KKZ-ve të emëruar nga KQZ për të gjitha komunat e Kosovës. Këto të dhëna u krahasuan më pas me ato të emërimeve për Kryesuesit dhe Anëtarët e KKZ-ve për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 17 tetor dhe 14 nëntor 2021, për të vlerësuar ndryshimet në përbërje dhe përfaqësim në secilën komunë.

Së dyti, u nxorën të dhënat krahasimore për Kryesuesit, Anëtarët dhe Anëtarët Rezervë të KVV-ve për Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor dhe 14 nëntor 2021. Këtu u analizuan emërimet nga KQZ për Kryesuesit, Anëtarët dhe Anëtarët Rezervë të KVV-ve për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës më 14 shkurt 2021 dhe për Zgjedhjet Lokale më 17 tetor dhe 14 nëntor 2021. Ky krahasim i të dhënave për secilën komunë të Kosovës ndihmoi në identifikimin e trendeve dhe praktikave në përzgjedhjen dhe emërimin e stafit zgjedhor në periudha të ndryshme zgjedhore.

Në fund, raporti përfshin gjithashtu rekomandime për adresimin e çështjeve të përfaqësimit të drejtë dhe pjesëmarrjes gjinore në trupat menaxhuese të zgjedhjeve. Këto rekomandime përfshijnë propozime për përmirësimin e rregulloreve zgjedhore dhe udhëzime për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me angazhimin dhe bashkëpunimin me partitë politike, si dhe rritjen e përfaqësimit të grave në trupat zgjedhore në nivelin komunal dhe qendror.

ANALIZA E PËRFAQËSIMIT GJINOR NË TRUPAT PËR MENAXHIMIN E ZGJEDHJEVE

Lista e emërimeve të KKZ-ve (*Vendim i KQZ-së nr.104/2021 i datës 15.01.2021*) për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 14 shkurt 2021, përfshinte gjithsejtë **300 persona të emëruar në 38 komuna** të Republikës së Kosovës. Nga këta, **38 ishin Kryesues të KKZ-ve, 262 ishin Anëtar të KKZ-ve**, duke përbërë një total prej 300 Kryesues dhe Anëtarësh në të gjitha komunat.

Ndërkohë, lista e emërimeve të KKZ-ve (*Vendim i KQZ-së nr.1719/2021 i datës 30.06.2021*) për Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor 2021, përfshinte gjithsejtë **281 persona**, të cilët kanë qenë të emëruar në 38 komuna të Republikës së Kosovës. Nga këta **38 ishin Kryesues të KKZ-ve dhe 243 ishin Anëtar të KKZ-ve**, duke përbërë një total prej 281 Kryesues dhe Anëtarësh në të gjitha komunat.

Emërimet e Kryesuesve, Anëtarëve dhe Anëtarëve rezervë të KVV-ve – të dhënat e përgjithshme nga Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 14 shkurt 2021 si dhe në Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor 2021 në Republikën e Kosovës

- ◆ Nga gjithsejtë **888 qendra të votimit** dhe në **2,382 vendvotime** me datën 14.02.2021:
 - ↳ **15,078 Kryesues, Anëtar dhe Anëtar Rezervë të KVV-ve** në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 14 shkurt 2021, **5.223 kanë qenë gra**, dhe **11.897 prej tyre burra**. Shprehur në përqindje i bie, se 30.51% prej tyre kanë qenë gra dhe 69.49% prej tyre burra.
- ◆ Nga gjithsejtë **883 qendra të votimit** dhe në **2,477 vendvotime** me datën 17.10-14.11.2021:

- ↳ **17,120 Kryesues, Anëtar dhe Anëtar Rezervë të KVV-ve** në Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor dhe 14 nëntor 2021, **4.668 kanë qenë gra**, dhe **10.410 prej tyre burra**. Shprehur në përqindje i bie, se 30.96% prej tyre kanë qenë gra dhe 69.04% prej tyre burra.

Krahasimet e përqindjes gra dhe burra në përfaqësimin e KKZ-ve në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 14 shkurt 2021

Në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 14 shkurt 2021, gjithsejtë ishin të emëruar **300 Kryesues dhe Anëtar të KKZ-ve** nga KQZ-ja, që shërbyen në secilën komunë përkatëse sipas emërimeve dhe përfaqësimit politik. Ndërsa, në Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor 2021 ishin gjithsejtë **281 Kryesues dhe Anëtar të KKZ-ve**, që shërbyen në secilën komunë përkatëse sipas emërimeve dhe përfaqësimit politik.

Nga krahasimi me numrin e përgjithshëm të emërimeve nga Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 14 shkurt 2021, në Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor 2021 ka një rritje të përfaqësimit të grave prej vetëm 0.45%.

Krahasimet e përqindjes gra dhe burra në përfaqësimin e KVV-ve në Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor 2021

Departamenti i Koordinimit në Terren i SKQZ-së për hartimin e këtij raporti ka bërë nxjerrjen e të dhënave nga listat e nominimeve të subjekteve politike dhe nga ato të emërimeve të tyre nga KQZ, për secilën komunë përkatëse për numrin e përgjithshëm dhe për pozitat e tyre.

Nga 38 komuna, me gjithsejtë 2,477 vendvotime, DKT ka mbledhur të dhënat për secilin vendvotim, duke përfshirë përbërjen e pozitave dhe përfaqësimit gjinor, me një fokus të veçantë në përfaqësimin e grave në TMZ. Kjo përfshirje përfaqëson 100% të vendvotimeve, duke ofruar një pamje të plotë dhe të saktë të përfaqësimit gjinor në gjithë procesin zgjedhor.

Përfaqësimi i grave në proceset zgjedhore dhe të gjeturat që dalin nga ky raport

Përfshirja e grave në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit, veçanërisht në trupat menaxhuese zgjedhore, ka marrë vlerësime të ndryshme. Sa i përket përfaqësimit të grave, është evidentuar një disbalancë e dukshme midis grave dhe burrave në listat e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe Këshillave të Vendvotimeve (KVV), duke treguar se grave nuk u është ofruar hapësira e barabartë për përfaqësim në trupat menaxhuese të zgjedhjeve (TMZ). Kjo bie në kundërshtim me Ligjin për Barazinë Gjinore dhe me parimet bazë të demokracisë, që kërkojnë zbatimin e kuotës gjinore. Në këto zgjedhje, pothuajse të gjitha subjektet politike kanë dështuar të respektojnë edhe kriterin minimal të përfshirjes së gjinisë më pak të përfaqësuar, prej 30%, në propozimet e tyre për përbërjen e TMZ-ve.

Sa i përket trupave menaxhuese të zgjedhjeve, përfaqësimi i grave vijon të mbetet ndjeshëm i nën-përfaqësuar. Në Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe Këshillat e Vendvotimeve (KVV), gratë shpesh nuk arrijnë të përfshihen as me kriterin minimal prej 30%. Ky trend i mos përfshirjes është i dukshëm edhe në përbërjen gjinore të KKZ-ve. Edhe pse Sekretariati i KQZ-së ka bërë thirrje që subjektet politike të nominojnë më shumë gra si anëtare në këto komisione, në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 14 shkurt 2021, nga gjithsej 262 anëtarë, vetëm 46 prej tyre ishin gra, që përbënë 15.33%. Ndërsa në Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 17 tetor 2021, përfaqësimi i grave në nivel vendi ishte 19.33%. Këto shifra dëshmojnë se gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar në trupat menaxhuese të zgjedhjeve, pavarësisht përpjekjeve për të rritur pjesëmarrjen e tyre.

Lidhur me këtë, nuk është respektuar as përcaktimi ligjor nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), i cili kërkon nga

Sekretariati i KQZ-së t'i kushtojë vëmendje të veçantë përfaqësimit të drejtë gjinor gjatë emërimit të Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ).

Nga përbërja e secilës komunë, vërehet që vetëm një numër i vogël i KKZ-ve kanë pasur edhe përfaqësim minimal prej 30% të grave.

Zubin Potoku është komuna që prinë në përbërje të KKZ-së ku ka pasur të përfaqësuar më shumë gra se burra, në raportin 77.78% gra dhe 22.22% burra. Sipas përqindjeve të përfaqësimit të grave, pasojnë KKZ-të e komunave Partesh (60% gra dhe 40% burra), Leposaviq (45% gra dhe 54.55 burra), Drenasi (33.33% gra dhe 66.67 burra).

Kurse, 14 komuna që fare nuk kanë pasur përfaqësim të grave në përbërjet e KKZ-ve siç janë: *Deçan, Dragash, Klinë, Kamenicë, Obiliq, Rahovec, Podujevë, Ferizaj, Viti, Vushtri, Malishevë, Junik, Graçanicë dhe Ranillukë*. Kjo flet për një tendencë dhe qasje shpërfillëse ndaj grave nga ana e subjekteve politike, veçanërisht në komunat e mëdha dhe zonat urbane, duke mos i përfshirë të njëjtat në trupat menaxhuese të zgjedhjeve.

Ndërsa, në Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor 2021 nga përbërja e secilës komunë, vërehet që vetëm një numër i vogël i KKZ-ve kanë pasur edhe përfaqësim minimal prej 30% të grave.

Zubin Potoku prapë edhe në Zgjedhjet Lokale prinë si komunë, ku në përbërje të KKZ-së ka më shumë gra se burra, në raportin 77.78% gra dhe 22.22% burra. Sipas përqindjeve të përfaqësimit të grave, pasojnë KKZ-të e komunave Partesh (60% gra dhe 40% burra), Leposaviq (45% gra dhe 54.55 burra), Glllogoc (33.33% gra dhe 66.67 burra).

Që janë plot 13 komuna, KKZ-të e së cilave nuk kanë patur asnjë grua në përbërjet e tyre.

Përfaqësimi gjinor në trupat për menaxhimin e zgjedhjeve

Komunat në fjalë janë; *Dragash, Klinë, Kamenica, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Rahovec, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri, Graçanicë dhe Ranillukë*. Kjo flet për një qasje shpërfillëse ndaj grave nga ana e subjekteve politike, veçanërisht në komunat e mëdha dhe zonat urbane, duke mos i përfshirë të njëjtat në trupat menaxhuese të zgjedhjeve.

Përfaqësimi i ulët e grave vërehet edhe tek Këshillat e Vendotimeve (KVV), të cilët kanë përgjegjësi për administrimin e procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve. Megjithkëtë, për dallim nga KKZ-të, në disa komuna ka rritje të përfaqësimit të grave në KVV. Edhe pse ka pasur dakordimit në mes të subjekteve politike për përfaqësim të grave në administrim të zgjedhjeve, të dhënat nga nominimet e subjekteve politike dhe emërimeve nga KQZ për Këshillat e Vendotimeve (KVV) tregojnë se vetëm 30.51% e anëtarëve të KVV-ve në nivel vendi ishin gra, ndërsa në Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor 2021 ky përqindje u rrit lehtësisht në 30.96%.

Nga përbërja e secilës komunë, në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 14 shkurt 2021 vërehet që 18 komuna kanë pasur përfaqësim mbi 30% të grave në përfaqësim të KVV-ve, në komunat me renditjet nga e para pasuar nga komunat tjera, si në vijim; Mitrovica e Veriut, Prishtina, Ranillukë, Mitrovica e Jugut, Gllogoc, Ferizaj, Pejë, Fushë Kosovë, Prizren, Gjakovë, Zveçan, Junik, Gjilan, Kaçanik, Vushtrri, Obiliq, Graçanicë dhe Deçan.

Ndërsa, nga përbërja e secilës komunë, në Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor 2021, vërehet që 15 komuna kanë pasur përfaqësim mbi 30% të grave në përfaqësim të KVV-ve, në komunat si në vijim; Mitrovica e Veriut, Prishtina, Mitrovica e Jugut, Ferizaj, Pejë, Gllogoc, Ranillukë, Obiliq, Fushë Kosovë, Kaçanik, Dragash, Suharekë, Gjakovë, Deçan dhe Zveçan.

Pra, përkundër mos përfshirjes së grave në mënyrë të barabartë në trupat menaxhuese të zgjedhjeve dhe retorikës së shtuar nga subjektet politike për promovimin e përfaqësimit të barabartë gjinor, ato nuk u kanë ofruar grave qasje të njëjtë në organet përgjegjëse për menaxhimin dhe organizimin e zgjedhjeve.

Megjithatë, përfshirja e grave ka qenë në nivel të kënaqshëm tek trajnerët e angazhuar nga Sekretariati i KQZ-së në KKZ-të e secilës komunë. Nga gjithsej 274 persona të angazhuar, më shumë se gjysma e tyre, përkatësisht 54%, kanë qenë gra, duke treguar një nivel të lartë të përfaqësimit gjinor në këtë aspekt.

Rekomandimet

Me qëllim të arritjes së përfaqësimit të barabartë gjinor në të gjitha trupat e menaxhimit të procesit zgjedhor, raporti ofron rekomandimet e mëposhtme:

1

Të përcaktohet qartë në Rregullat zgjedhore që KQZ-ja ka për detyrë të sigurojë përfaqësim të drejtë në Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ), duke përfshirë edhe balancën gjinore.

2

KQZ të organizojë takime pune me partitë politike në nivel qendror dhe nivel lokal për t'i njoftuar ato me detyrimet ligjore që i obligojnë të zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në organet dhe trupat e partive, në përputhje me nenin 6 të Ligjit Nr.05/L-020 për Barazinë Gjinore.

3

Duke zbatuar nenin 67, paragrafin 3 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, KQZ-ja duhet të përpiqet ta sigurojë përfaqësim të drejtë, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen gjinore në të gjitha trupat menaxhues të zgjedhjeve, përfshirë KKZ-të dhe KVV-të.

4

KQZ-ja duhet të kërkojë nga subjektet politike që të nominojnë më shumë gra në përbërjen e Komisioneve Komunale Zgjedhore, Këshillave të Vendvotimeve, Ekipeve Mobile dhe për Anëtarët e Qendrave Komunale të Numërimit. Në të ardhmen, përpjekjet duhet të intensifikohen për të siguruar një përfaqësim të barabartë gjinor 50-50 në trupat menaxhuese të zgjedhjeve.

SHTOJCAT

Shtojca 1:

Të dhënat e përgjithshme të KKZ-ve dhe të dhënat e shprehura në përqindje për numrin e anëtareve gra dhe burra për çdo komunë në Zgjedhjet Parlamentare 14 shkurt 2021

| Komunat | Kryesues | Anëtar | Gjithsejtë | Gra | Burra | Përfaqësimi Gra | Përfaqësimi Burra |
|-------------------|----------|--------|------------|-----|-------|--------------------|----------------------|
| Deçan | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Gjakovë | 1 | 6 | 7 | 1 | 6 | 14% | 86% |
| Glllogoc | 1 | 5 | 6 | 2 | 4 | 33% | 67% |
| Gjilan | 1 | 7 | 8 | 2 | 6 | 25% | 75% |
| Dragash | 1 | 8 | 9 | 0 | 9 | 0% | 100% |
| Istog | 1 | 7 | 8 | 1 | 7 | 13% | 88% |
| Kaçanik | 1 | 5 | 6 | 1 | 5 | 17% | 83% |
| Klinë | 1 | 8 | 9 | 0 | 9 | 0% | 100% |
| Fushë Kosovë | 1 | 8 | 9 | 2 | 7 | 22% | 78% |
| Kamenicë | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Mitrovicë e Jugut | 1 | 7 | 8 | 1 | 7 | 13% | 88% |
| Leposaviq | 1 | 10 | 11 | 5 | 6 | 45% | 55% |
| Lipjan | 1 | 8 | 9 | 1 | 8 | 11% | 89% |
| Novobërdë | 1 | 8 | 9 | 2 | 7 | 22% | 78% |
| Obiliq | 1 | 7 | 8 | 0 | 8 | 0% | 100% |
| Rahovec | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Pejë | 1 | 8 | 9 | 2 | 7 | 22% | 78% |
| Podujevë | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Prishtinë | 1 | 8 | 9 | 1 | 8 | 11% | 89% |
| Prizren | 1 | 9 | 10 | 1 | 9 | 10% | 90% |
| Skenderaj | 1 | 6 | 7 | 1 | 6 | 14% | 86% |
| Shtime | 1 | 6 | 7 | 2 | 5 | 29% | 71% |
| Shtërpcë | 1 | 8 | 9 | 2 | 7 | 22% | 78% |
| Suharekë | 1 | 6 | 7 | 1 | 6 | 14% | 86% |
| Ferizaj | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Viti | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Vushtrri | 1 | 7 | 8 | 0 | 8 | 0% | 100% |
| Zubin Potok | 1 | 8 | 9 | 7 | 2 | 78% | 22% |
| Zveçan | 1 | 6 | 7 | 1 | 6 | 14% | 86% |
| Malishevë | 1 | 5 | 6 | 0 | 6 | 0% | 100% |
| Junik | 1 | 5 | 6 | 0 | 6 | 0% | 100% |

| Komunat | Kryesues | Anëtar | Gjithsejtë | Gra | Burra | Përfaqësimi Gra | Përfaqësimi Burra |
|--------------------|-----------|------------|------------|-----------|------------|--------------------|----------------------|
| Mamushë | 1 | 8 | 9 | 2 | 7 | 22% | 78% |
| Hani i Elezit | 1 | 5 | 6 | 1 | 5 | 17% | 83% |
| Graçanicë | 1 | 9 | 10 | 0 | 10 | 0% | 100% |
| Ranillug | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Partesh | 1 | 4 | 5 | 3 | 2 | 60% | 40% |
| Kllokot | 1 | 8 | 9 | 1 | 8 | 11% | 89% |
| Mitrovicë e Veriut | 1 | 10 | 11 | 3 | 8 | 27% | 73% |
| Gjithsejtë | 38 | 262 | 300 | 46 | 254 | | |

Shtojca 2:

Të dhënat e përgjithshme të KKZ-ve për secilën komunë përkatëse dhe të dhënat e shprehura në krahasimin në përqindje në dy palë zgjedhjet për numrin e anëtareve gra dhe burra për çdo komunë në Zgjedhjet Parlamentare 14 shkurt 2021 dhe Zgjedhjet Lokale 17 tetor 2021

Përfaqësimi gjinor në KKZ për Zgjedhjet Parlamentare dhe Lokale 2021

| Komuna | Përfaqësimi Gra | Përfaqësimi Burra | Zgjedhjet |
|-------------------|--------------------|----------------------|--------------------------------------|
| Deçan | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 20% | 80% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Gjakovë | 14% | 86% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 14% | 86% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Glllogovc | 33% | 67% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 29% | 71% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Gjilan | 25% | 75% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 29% | 71% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Dragash | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 0% | 100% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Istog | 13% | 88% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 22% | 78% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Kaçanik | 17% | 83% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 20% | 80% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Klinë | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 0% | 100% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Fushë Kosovë | 22% | 78% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 25% | 75% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Kamenicë | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 0% | 100% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Mitrovicë e Jugut | 13% | 88% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 0% | 100% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Leposaviq | 45% | 55% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 36% | 64% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Lipjan | 11% | 89% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 33% | 67% | Zgjedhjet Lokale 2021 |

| | | | |
|---------------|-----|------|--------------------------------------|
| Novobërdë | 22% | 78% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 25% | 75% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Obiliq | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 0% | 100% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Rahovec | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 0% | 100% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Pejë | 22% | 78% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 33% | 67% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Podujevë | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 17% | 83% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Prishtinë | 11% | 89% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 33% | 67% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Prizren | 10% | 90% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 11% | 89% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Skenderaj | 14% | 86% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 0% | 100% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Shtime | 29% | 71% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 43% | 57% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Shtërpcë | 22% | 78% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 22% | 78% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Suharekë | 14% | 86% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 0% | 100% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Ferizaj | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 14% | 86% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Viti | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 14% | 86% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Vushtri | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 0% | 100% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Zubin Potok | 78% | 22% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 78% | 22% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Zveçan | 14% | 86% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 11% | 89% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Malishevë | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 29% | 71% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Junik | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 20% | 80% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Mamushë | 22% | 78% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 25% | 75% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Hani i Elezit | 17% | 83% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 20% | 80% | Zgjedhjet Lokale 2021 |

**Përfaqësimi gjinor në
trupat për menaxhimin e
zgjedhjeve**

| | | | |
|--------------------|-----|------|--------------------------------------|
| Graçanicë | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 0% | 100% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Ranilluk | 0% | 100% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 0% | 100% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Partesh | 60% | 40% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 50% | 50% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Kllokot | 11% | 89% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 14% | 86% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Mitrovicë e Veriut | 27% | 73% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 20% | 80% | Zgjedhjet Lokale 2021 |

Shtojca 3:

Të dhënat e përgjithshme të KVV-ve për secilën komunë përkatëse të dhënat shprehura në krahësimin në përqindje në dy palë zgjedhjet për numrin e anëtareve gra dhe burra për çdo komunë në Zgjedhjet Parlamentare të datë 14.02.2021 dhe Zgjedhjet Lokale të datë 14.11.2021

Përfaqësimi gjinor në KVV

| Komuna | Përfaqësimi Gra | Përfaqësimi Burra | Zgjedhjet |
|-------------------|--------------------|----------------------|--------------------------------------|
| Deçan | 30% | 70% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 32% | 68% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Gjakovë | 33% | 67% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 32% | 68% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Glllogoc | 36% | 64% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 38% | 63% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Gjilan | 32% | 68% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 34% | 66% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Dragash | 7% | 93% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 9% | 91% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Istog | 22% | 78% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 27% | 73% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Kaçanik | 32% | 68% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 34% | 66% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Klinë | 19% | 81% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 18% | 82% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Fushë Kosovë | 34% | 66% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 35% | 65% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Kamenicë | 26% | 74% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 26% | 74% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Mitrovicë e Jugut | 38% | 62% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 40% | 60% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Leposaviq | 27% | 73% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 25% | 75% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Lipjan | 27% | 73% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 27% | 73% | Zgjedhjet Lokale 2021 |

**Përfaqësimi gjinor në
trupat për menaxhimin e
zgjedhjeve**

| Komuna | Përfaqësimi Gra | Përfaqësimi Burra | Zgjedhjet |
|-------------|--------------------|----------------------|--------------------------------------|
| Novobërdë | 20% | 80% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 17% | 83% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Obiliq | 30% | 70% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 36% | 64% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Rahovec | 23% | 77% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 21% | 79% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Pejë | 35% | 65% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 39% | 61% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Podujevë | 25% | 75% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 24% | 76% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Prishtinë | 45% | 55% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 43% | 57% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Prizren | 33% | 67% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 32% | 68% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Skenderaj | 22% | 78% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 20% | 80% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Shtime | 30% | 70% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 29% | 71% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Shtërpcë | 14% | 86% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 8% | 92% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Suharekë | 30% | 70% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 33% | 67% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Ferizaj | 36% | 64% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 39% | 61% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Viti | 23% | 77% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 29% | 71% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Vushtrri | 31% | 69% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 28% | 72% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Zubin Potok | 24% | 76% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 25% | 75% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Zveçan | 33% | 67% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 31% | 69% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Malishevë | 16% | 84% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 19% | 81% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Junik | 33% | 68% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 10% | 90% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Mamushë | 3% | 97% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 0% | 100% | Zgjedhjet Lokale 2021 |

| Komuna | Përfaqësimi Gra | Përfaqësimi Burra | Zgjedhjet |
|--------------------|--------------------|----------------------|--------------------------------------|
| Hani i Elezit | 21% | 79% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 12% | 88% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Graçanicë | 30% | 70% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 21% | 79% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Ranilluk | 45% | 55% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 36% | 64% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Partesh | 15% | 85% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 17% | 83% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Kllokot | 26% | 74% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 27% | 73% | Zgjedhjet Lokale 2021 |
| Mitrovicë e Veriut | 46% | 54% | Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2021 |
| | 43% | 57% | Zgjedhjet Lokale 2021 |

Shtojca 4:

Të dhënat e përgjithshme të KKZ-ve dhe të dhënat shprehura në përqindje për numrin e anëtareve gra dhe burra për çdo komunë në Zgjedhjet Lokale 17 tetor 2021

| Komunat | Kryesues | Anëtar | Gjithsejtë | Gra | Burra | Përfaqësimi Gra | Përfaqësimi Burra |
|-------------------|----------|--------|------------|-----|-------|--------------------|----------------------|
| Deçan | 1 | 4 | 5 | 1 | 4 | 20% | 80% |
| Gjakovë | 1 | 6 | 7 | 1 | 6 | 14% | 86% |
| Glllogoc | 1 | 6 | 7 | 2 | 5 | 29% | 71% |
| Gjilan | 1 | 6 | 7 | 2 | 5 | 29% | 71% |
| Dragash | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Istog | 1 | 8 | 9 | 2 | 7 | 22% | 78% |
| Kaçanik | 1 | 4 | 5 | 1 | 4 | 20% | 80% |
| Klinë | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Fushë Kosovë | 1 | 7 | 8 | 2 | 6 | 25% | 75% |
| Kamenicë | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Mitrovicë e Jugut | 1 | 5 | 6 | 0 | 6 | 0% | 100% |
| Leposaviq | 1 | 10 | 11 | 4 | 7 | 36% | 64% |
| Lipjan | 1 | 8 | 9 | 3 | 6 | 33% | 67% |
| Novobërdë | 1 | 7 | 8 | 2 | 6 | 25% | 75% |
| Obiliq | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Rahovec | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Pejë | 1 | 8 | 9 | 3 | 6 | 33% | 67% |
| Podujevë | 1 | 5 | 6 | 1 | 5 | 17% | 83% |
| Prishtinë | 1 | 8 | 9 | 3 | 6 | 33% | 67% |
| Prizren | 1 | 8 | 9 | 1 | 8 | 11% | 89% |
| Skenderaj | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Shtime | 1 | 6 | 7 | 3 | 4 | 43% | 57% |
| Shtërpcë | 1 | 8 | 9 | 2 | 7 | 22% | 78% |
| Suharekë | 1 | 4 | 5 | 0 | 5 | 0% | 100% |
| Ferizaj | 1 | 6 | 7 | 1 | 6 | 14% | 86% |
| Viti | 1 | 6 | 7 | 1 | 6 | 14% | 86% |
| Vushtrri | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Zubin Potok | 1 | 8 | 9 | 7 | 2 | 78% | 22% |
| Zveçan | 1 | 8 | 9 | 1 | 8 | 11% | 89% |
| Malishevë | 1 | 6 | 7 | 2 | 5 | 29% | 71% |
| Junik | 1 | 4 | 5 | 1 | 4 | 20% | 80% |
| Mamushë | 1 | 7 | 8 | 2 | 6 | 25% | 75% |
| Hani i Elezit | 1 | 4 | 5 | 1 | 4 | 20% | 80% |

Analizë e të dhënave të Zgjedhjeve
për Kuvendin e Kosovës dhe të
Zgjedhjeve Lokale të vitit 2021

| Komunat | Kryesues | Anëtar | Gjithsejtë | Gra | Burra | Përfaqësimi Gra | Përfaqësimi Burra |
|-----------------------|-----------|------------|------------|-----------|------------|--------------------|----------------------|
| Graçanicë | 1 | 8 | 9 | 0 | 9 | 0% | 100% |
| Ranillug | 1 | 6 | 7 | 0 | 7 | 0% | 100% |
| Partesh | 1 | 5 | 6 | 3 | 3 | 50% | 50% |
| Kllokot | 1 | 6 | 7 | 1 | 6 | 14% | 86% |
| Mitrovicë e Veriut | 1 | 9 | 10 | 2 | 8 | 20% | 80% |
| Gjithsejtë | 38 | 243 | 281 | 55 | 226 | | |

Shtojca 5:

Të dhënat e përgjithshme të KVV-ve dhe të dhënat shprehura në përqindje për numrin e anëtareve gra dhe burra për çdo komunë në Zgjedhjet Parlamentare 14 shkurt 2021

| Komunat | Kryesues | Anëtar | Rezervë | Gjithsejtë | Gra | Burra | Përfaqësimi Gra | Përfaqësimi Burra |
|----------------------|----------|--------|---------|------------|-----|-------|--------------------|----------------------|
| Deçan | 54 | 250 | 23 | 327 | 99 | 228 | 30% | 70% |
| Gjakovë | 142 | 710 | 83 | 935 | 306 | 629 | 33% | 67% |
| Glllogoc | 72 | 288 | 53 | 413 | 150 | 263 | 36% | 64% |
| Gjilan | 129 | 645 | 76 | 850 | 271 | 579 | 32% | 68% |
| Dragash | 60 | 377 | 62 | 499 | 34 | 465 | 7% | 93% |
| Istog | 63 | 346 | 57 | 466 | 102 | 364 | 22% | 78% |
| Kaçanik | 47 | 188 | 25 | 260 | 82 | 178 | 32% | 68% |
| Klinë | 64 | 306 | 59 | 429 | 81 | 348 | 19% | 81% |
| Fushë Kosovë | 48 | 255 | 42 | 345 | 119 | 226 | 34% | 66% |
| Kamenicë | 56 | 232 | 43 | 331 | 85 | 246 | 26% | 74% |
| Mitrovicë e Jugut | 104 | 548 | 59 | 711 | 269 | 442 | 38% | 62% |
| Leposaviq | 31 | 155 | 28 | 214 | 57 | 157 | 27% | 73% |
| Lipjan | 81 | 389 | 61 | 531 | 145 | 386 | 27% | 73% |
| Novobërdë | 22 | 141 | 24 | 187 | 38 | 149 | 20% | 80% |
| Obiliq | 35 | 151 | 31 | 217 | 66 | 151 | 30% | 70% |
| Rahovec | 80 | 333 | 75 | 488 | 110 | 378 | 23% | 77% |
| Pejë | 138 | 683 | 85 | 906 | 317 | 589 | 35% | 65% |
| Podujevë | 115 | 503 | 61 | 679 | 173 | 506 | 25% | 75% |
| Prishtinë | 241 | 1146 | 122 | 1509 | 678 | 831 | 45% | 55% |
| Prizren | 222 | 1469 | 270 | 1961 | 654 | 1307 | 33% | 67% |
| Skenderaj | 77 | 315 | 66 | 458 | 99 | 359 | 22% | 78% |
| Shtime | 34 | 175 | 30 | 239 | 71 | 168 | 30% | 70% |
| Shtërpcë | 21 | 142 | 24 | 187 | 27 | 160 | 14% | 86% |
| Suharekë | 89 | 394 | 48 | 531 | 157 | 374 | 30% | 70% |
| Ferizaj | 147 | 735 | 132 | 1014 | 364 | 650 | 36% | 64% |
| Viti | 67 | 270 | 35 | 372 | 86 | 286 | 23% | 77% |
| Vushtrri | 96 | 486 | 52 | 634 | 198 | 436 | 31% | 69% |
| Zubin Potok | 16 | 66 | 20 | 102 | 24 | 78 | 24% | 76% |
| Zveçan | 13 | 65 | 15 | 93 | 31 | 62 | 33% | 67% |
| Malishevë | 74 | 296 | 49 | 419 | 68 | 351 | 16% | 84% |
| Junik | 7 | 28 | 5 | 40 | 13 | 27 | 33% | 68% |

| Komunat | Kryesues | Anëtar | Rezervë | Gjithsejtë | Gra | Burra | Përfaqësimi Gra | Përfaqësimi Burra |
|--------------------|-------------|--------------|-------------|--------------|-------------|--------------|--------------------|----------------------|
| Mamushë | 5 | 24 | 6 | 35 | 1 | 34 | 3% | 97% |
| Hani i Elezit | 12 | 48 | 7 | 67 | 14 | 53 | 21% | 79% |
| Graçanicë | 32 | 244 | 31 | 307 | 93 | 214 | 30% | 70% |
| Ranillug | 10 | 40 | 8 | 58 | 26 | 32 | 45% | 55% |
| Partesh | 7 | 28 | 6 | 41 | 6 | 35 | 15% | 85% |
| Kllokot | 7 | 49 | 9 | 65 | 17 | 48 | 26% | 74% |
| Mitrovicë e Veriut | 27 | 135 | 38 | 200 | 92 | 108 | 46% | 54% |
| Gjithsejtë | 2545 | 12655 | 1920 | 17120 | 5223 | 11897 | | |

Shtojca 6:

Të dhënat e përgjithshme të KVV-ve dhe të dhënat shprehura në përqindje për numrin e anëtareve gra dhe burra për çdo komunë në Zgjedhjet Lokale 17 tetor 2021


| Komunat | Kryesues | Anëtar | Rezervë | Gjithsejtë | Gra | Burra | Përfaqësimi Gra | Përfaqësimi Burra |
|----------------------|----------|--------|---------|------------|-----|-------|--------------------|----------------------|
| Deçan | 50 | 200 | 25 | 275 | 88 | 187 | 32% | 68% |
| Gjakovë | 139 | 556 | 104 | 799 | 259 | 540 | 32% | 68% |
| Glllogoc | 73 | 292 | 35 | 400 | 150 | 250 | 38% | 63% |
| Gjilan | 126 | 630 | 83 | 839 | 285 | 554 | 34% | 66% |
| Dragash | 58 | 258 | 29 | 345 | 30 | 315 | 9% | 91% |
| Istog | 60 | 240 | 31 | 331 | 90 | 241 | 27% | 73% |
| Kaçanik | 46 | 184 | 25 | 255 | 87 | 168 | 34% | 66% |
| Klinë | 60 | 240 | 31 | 331 | 58 | 273 | 18% | 82% |
| Fushë Kosovë | 50 | 250 | 30 | 330 | 117 | 213 | 35% | 65% |
| Kamenicë | 54 | 216 | 27 | 297 | 78 | 219 | 26% | 74% |
| Mitrovicë e Jugut | 101 | 499 | 59 | 659 | 263 | 396 | 40% | 60% |
| Leposaviq | 25 | 100 | 25 | 150 | 38 | 112 | 25% | 75% |
| Lipjan | 82 | 328 | 50 | 460 | 123 | 337 | 27% | 73% |
| Novobërdë | 22 | 106 | 21 | 149 | 25 | 124 | 17% | 83% |
| Obiliq | 34 | 136 | 32 | 202 | 72 | 130 | 36% | 64% |
| Rahovec | 78 | 312 | 88 | 478 | 98 | 380 | 21% | 79% |
| Pejë | 130 | 520 | 76 | 726 | 280 | 446 | 39% | 61% |
| Podujevë | 111 | 445 | 58 | 614 | 150 | 464 | 24% | 76% |
| Prishtinë | 238 | 1160 | 114 | 1512 | 648 | 864 | 43% | 57% |
| Prizren | 222 | 1296 | 285 | 1803 | 568 | 1235 | 32% | 68% |
| Skenderaj | 75 | 300 | 53 | 428 | 85 | 343 | 20% | 80% |
| Shtime | 35 | 140 | 39 | 214 | 63 | 151 | 29% | 71% |
| Shtërpcë | 18 | 87 | 13 | 118 | 10 | 108 | 8% | 92% |
| Suharekë | 85 | 340 | 45 | 470 | 154 | 316 | 33% | 67% |
| Ferizaj | 143 | 576 | 72 | 791 | 306 | 485 | 39% | 61% |
| Viti | 66 | 264 | 35 | 365 | 106 | 259 | 29% | 71% |
| Vushtri | 98 | 392 | 59 | 549 | 154 | 395 | 28% | 72% |
| Zubin Potok | 14 | 57 | 24 | 95 | 24 | 71 | 25% | 75% |
| Zveçan | 12 | 48 | 11 | 71 | 22 | 49 | 31% | 69% |
| Malishevë | 74 | 296 | 37 | 407 | 76 | 331 | 19% | 81% |
| Junik | 5 | 20 | 5 | 30 | 3 | 27 | 10% | 90% |

| Komunat | Kryesues | Anëtar | Rezervë | Gjithsejtë | Gra | Burra | Përfaqësimi Gra | Përfaqësimi Burra |
|--------------------|-------------|--------------|-------------|--------------|-------------|--------------|--------------------|----------------------|
| Mamushë | 5 | 20 | 5 | 30 | 0 | 30 | 0% | 100% |
| Hani i Elezit | 11 | 44 | 5 | 60 | 7 | 53 | 12% | 88% |
| Graçanicë | 30 | 120 | 28 | 178 | 37 | 141 | 21% | 79% |
| Ranillug | 10 | 40 | 6 | 56 | 20 | 36 | 36% | 64% |
| Partesh | 7 | 28 | 7 | 42 | 7 | 35 | 17% | 83% |
| Kllokot | 7 | 35 | 6 | 48 | 13 | 35 | 27% | 73% |
| Mitrovicë e Veriut | 23 | 115 | 33 | 171 | 74 | 97 | 43% | 57% |
| Gjithsejtë | 2477 | 10890 | 1711 | 15078 | 4668 | 10410 | | |


Shtojca 7:

Paraqitja grafike - Të dhënat e shprehura në përqindje të përfaqësimit gra dhe burra sipas renditjes së komunave


01 - Deçan, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




02 - Gjakovë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.



03 - Gllogoc, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




04 - Gjilan, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




Përfaqësimi gjinor në trupat për menaxhimin e zgjedhjeve


05 - Dragash, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




06 - Istog, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.



07 - Kaçanik, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




08 - Klinë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




Përfaqësimi gjinor në trupat për menaxhimin e zgjedhjeve


09-Fushë Kosovë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




10 - Kamenicë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.



11-Mitrovicë e Jugut, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




12 - Leposavic, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




Përfaqësimi gjinor në trupat për menaxhimin e zgjedhjeve


13 - Lipjan, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




14 - Novobërdë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




15 - Obiliq, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




16 - Rahovec, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




17 - Pejë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




18 - Podujevë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.



19 - Prishtinë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




20 - Prizren, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




Përfaqësimi gjinor në trupat për menaxhimin e zgjedhjeve


21 - Skenderaj, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




22 - Shtime, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.



23 - Shtërpçë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




24 - Suharekë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




Përfaqësimi gjinor në trupat për menaxhimin e zgjedhjeve


25 - Ferizaj, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




26 - Viti, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




27 - Vushtri, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




28 - Zubin Potok, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




29 - Zveçan, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




30 - Malishevë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




31 - Junik, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




32 - Mamushë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




33 - Hani i Elezit, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




34 - Graçanicë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.



35 - Ranillukë, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




36 - Partesh, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.




Përfaqësimi gjinor në trupat për menaxhimin e zgjedhjeve


37 - Kllokot, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.



38-Mitrovicë e Veriut, përfaqësimi gjinor në KKZ dhe KVV për zgjedhjet parlamentare dhe lokale 2021.



Mbështetur nga:



Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtet-ndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndër sektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik



Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni uebsajtin tonë: www.d4d-ks.org